Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-462
Datë 10.11.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për riakreditimin Oxford Studio– me 11 degë brenda Kosovës, 4 degë në Prishtinë, 2 degë në Gjilan, 2 degë ne Prizren, 1 degë në Klinë, 1 degë ne Istog, 1 degë në Gurrakoc, për periudhën 5 vjeçare, prej 31. 10. 2016 deri 31. 10. 2021 për kurse për:

   1.1. Gjuhë Angleze.

   Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   Kushtet:

   - Nxënësve dhe stafit në të gjitha qendrat duhet t'u organizohet një stimulim i situatës emergjente.
   - Të përmirësohet sistemi i vlerësimit të testit përfundimtar me gojë.
   - Të sigurohet dëshmi se vrojtimi i mësimdhënësve bëhet sipas standardeve bashkëkohore dhe në mënyrë konsistente në të gjitha qendrat.
   - Formulari i cili ka për qëllim mbledhjen e të dhënave mbi nevojat e mësimdhënësve për zhvillim profesional të jetë specifik.
   - Kontratat e punës të jenë më specifike sidomos në rastin e atyre që kryejnë edhe detyra tjera përpos mësimdhënies si dhe të respektohet Ligji i Punës në përcaktimin e orëve dhe pagesës.
   - Të aplikohet decentralizimi nëpër qendra.

- Puna e menaxhmentit kryesor dhe atij nëpër qendra të vlerësohet nga ana e stafit në mënyrë anonime dy herë gjatë vitit.
- Në secilën qendër duhet të ketë kuti të sugjerimeve dhe sistemi për mbledhjen dhe shqyrtimin e tyre.
- Inventari të ripërtërihet, sidomos në qendrat në rajon.
- Të dhënat e mbledhura nga formularët që u jepen kandidatëve për vlerësim të kursit dhe mësimdhënësve të analizohen dhe t'iu kthehen mësimdhënësve/qendrave përkatëse.
- Të përmirësohen kushtet fizike në objekte.

(Afati kohor: 28. 02. 2017).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Oxford Studio në Prishtinë; dhe
- AKK.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani